



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Korçë, më _____. 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Tombino betoni”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Tuba kullimi 44163110-4

Tuba kanalizimesh 44163130-0

VLERA E FONDIT LIMIT QË PROKUROHET: 2,492,985 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë PA TVSH.

Autoriteti Kontraktor ka llogaritur fondin limit duke u bazuar në manualin e cmimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuara, autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuara .

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuara . Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuara në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe të deklaruar në organet tatimore.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuara. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuara.

2.3 Raport analize për cilësinë e mallrave të leshuar nga një laborator i certifikuar në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Raport analizave është përcaktuar proporcionalisht dhe në përputhje me objektin e kontratës, bazuar në nenin 77, të LPP, si dhe nenin 40, par. 6, pika c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuara. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë përputhshmerinë e mallrave me standartet teknike si dhe për të garantuar cilësinë dhe origjinalitetin e mallrave.

2.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 mjet transporti:

Lloji i Makinerive	Sasia	PRONESIA
Mjet Transporti (kamion me vinc)	cope 1	Në pronesi ose me qera

- a) **Per mjetin duhet te paraqitet:** dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronesise, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.
- b) **Kur jane me qera te paraqitet:** kontrata e qerase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuara, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Meqënëse sasi të mallrave objekt prokurimi janë të shumta në numër, operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion mjete me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi me sukses.

2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se 1 (një) person **Shofer** për periudhën shtator 2025 -nëntor 2025 e dokumentuar kjo me vertetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (**eSig25**) nga të cilët:

Per shoferin duhet te paraqitet :

- Leje drejtimi e leshuar nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (për mjetet me gomë)
- Kontrata e punës

Në rastin kur mjetet janë me qera nuk është kusht që shoferi të jetë në listën e shqerisë.

Kriteri Nr. 2.4 dhe 2.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedëklarimit shtojcë 9. Dokumentet e kërkuara me sipër do të paraqiten nga OE të suksesshëm në MK, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuara, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zërat dhe vëllimet e preventivit dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimet e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Termat e referencës, sasitë, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike **Nr. 433 Prot., datë 05.12.2025**. Specifikimet teknike dhe sasitë janë hartuar pas verifikimeve të kryera në lidhje me nevojat për realizimin e furnizimit me Tombino betoni që ka ndërmarrja duke u bazuar edhe në përvoja të viteve të mëparshme.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Sasia, karakteristikat dhe treguesit cilësorë janë kërkuar sipas sasive dhe nevojave efektive për të përmbushur nevojat e ndërmarrjes në mënyrë të plotë për realizimin e shërbimeve në interes të komunitetit.

Nr	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Tuba betoni Φ 200 mm	ml	80
2	Tuba betoni Φ 300 mm	ml	250
3	Tuba betoni Φ 400 mm	ml	250
4	Tuba betoni Φ 500 mm	ml	200
5	Tuba betoni Φ 600 mm	ml	165
6	Tuba b/a Φ 800 mm	ml	125
7	Tuba b/a Φ 1000 mm	ml	50
8	Tuba b/a Φ 1200 mm	ml	5
9	Tuba b/a Φ 1500 mm	ml	5

Specifikime të përgjithshme

- Tuba betoni dhe tuba b/a të jenë sipas standarteve teknike të miratuara.
- Tuba betoni dhe tuba b/a të kenë gjatësi 100 cm.

Specifikime sipas Materialit

- Tuba betoni Φ 200 mm, Φ 300 mm, Φ 400 mm, Φ 500 mm, Φ 600 mm

Betoni te jete jo me pak se i klases C25. Trashesia e betonit jo me pak se 10 cm. Te jene te pajisura me gote.

- Tuba b/a Φ 800 mm, Φ 1000 mm

Betoni te jete i armuar jo me pak se i klases C30. Trashesia e betonit jo me pak se 10 cm. Te jene te pajisura me gote.

- Tuba b/a Φ 1200 mm

Betoni te jete i armuar jo me pak se i klases C30. Trashesia e betonit jo me pak se 12 cm. Te jene te pajisura me gote.

- Tuba b/a Φ 1500 mm

Betoni te jete i armuar jo me pak se i klases C30. Trashesia e betonit jo me pak se 14 cm.

Kontraktuesi duhet te furnizojë mallrat, objektin i prokurimit ne perputhje me standartet e kerkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri ne dorezimin ne vendin e percaktuar qe eshte magazina e ndermarrjes se Sherbimeve publike, Bashkia Korçe **jo me vone se 48 ore nga marrja e kerkeses.**

Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritura nga Titullari i Autoritetit Kontraktor , në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III. SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Përshkrimi i mallit	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Tuba betoni Φ 200 mm	80 ml	Në magazinën e NSHP-së	12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader
2	Tuba betoni Φ 300 mm	250 ml	Në magazinën e	12 muaj nga data e lidhjes

			NSHP-së	se mareveshjes kuader
3	Tuba betoni Φ 400 mm	250 ml	Në magazinën e NSHP-së	12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader
4	Tuba betoni Φ 500 mm	200 ml	Në magazinën e NSHP-së	12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader
5	Tuba betoni Φ 600 mm	165 ml	Në magazinën e NSHP-së	12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader
6	Tuba b/a Φ 800 mm	125 ml	Në magazinën e NSHP-së	12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader
7	Tuba b/a Φ 1000 mm	50 ml	Në magazinën e NSHP-së	12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader
8	Tuba b/a Φ 1200 mm	5 ml	Në magazinën e NSHP-së	12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader
9	Tuba b/a Φ 1500 mm	5 ml	Në magazinën e NSHP-së	12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader

Kontraktuesi duhet te furnizojë mallrat,objektin i prokurimit ne perputhje me standartet e kerkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri ne dorezimin ne vendin e percaktuar qe eshte magazina e ndermarrjes se Sherbimeve publike, Bashkia Korçe **jo me vone se 48 ore nga marrja e kerkeses.**

Afati: 12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader.

NJËSIA E PROKURIMIT